

D13. Model i Raportit të Vendimmarrjes së Komisionit të Përhershëm

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTER
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa, _____ nr. Tel _____, e-mail _____)

Komisioni i Përhershëm i Shëndetësisë, Mirëqenies Sociale , Rinisë dhe Barazisë Gjinore

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. ____ Datë 28/06/2026

Nr ____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. ____ datë _2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për **“PËR “MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026–2030 “.**

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Në mbështetje të nenit 24, pika 1 dhe nenit 54, pika “k” të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 64/2025, datë 06.11.2025 “Për barazinë gjinore”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 30.06.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe planit të saj të veprimit”; Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjit nr. 11/2026 “Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”; Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar; Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, të nënshkruar nga Bashkia Gjirokastrë; si dhe dokumentit “Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2030

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Barazia gjinore përbën një nga parimet themelore të zhvillimit demokratik, social dhe ekonomik të vendit. Garantimi i mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, si dhe përfshirja e tyre e barabartë në jetën ekonomike, sociale, kulturore dhe politike, është një ndër prioritetet kryesore të politikave kombëtare dhe vendore. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë një rol të rëndësishëm në këtë proces, pasi janë institucionet më pranë qytetarëve dhe mund të ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës së komuniteteve që përfaqësojnë.

Plani është ndërtuar mbi parimin e përfshirjes dhe mosdiskriminimit dhe synon të adresojë nevojat e grave, burrave, vajzave dhe djemve në të gjithë diversitetin e tyre, duke i kushtuar vëmendje të veçantë grupeve më të cënueshme, përfshirë gratë në zonat rurale, gratë kryefamiljare, gratë me aftësi të kufizuara, të moshuarat, viktimat e dhunës, si dhe grupet e tjera që përballen me forma të shumëfishta diskriminimi.

Vizioni i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2030 është ndërtimi i një Bashkie Gjirokastër ku gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë gëzojnë të drejta, mundësi dhe përfitime të barabarta në të gjitha fushat e jetës, duke kontribuar në mënyrë të barabartë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të komunitetit.

Miratimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2030 përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e qeverisjes vendore të ndjeshme gjinore dhe në avancimin e barazisë ndërmjet grave dhe burrave në Bashkinë Gjirokastër. Dokumenti krijon bazën për planifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve konkrete gjatë pesë viteve të ardhshme dhe kontribuon në përmbushjen e objektivave kombëtare dhe ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)

Gjithsej për vitin e parë 2026 ,	19,320 mije leke
Gjithsej për vitin e dytë 2027 ,	122,175 mije leke
Gjithsej për vitin të tretë 2028 ,	122,175 mije leke
Gjithsej për vitin e katërt 2029 ,	122,175 mije leke
Gjithsej për 5 vjet ,	508,020 mije leke

Drejtoria / Sektori .pergjejes: Drejtoria e Sherbimit Social

Monitorimi dhe raportimi: (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Komisioni i Përhershëm i Shëndetësisë, Mirëqenies Sociale , Rinisë dhe Barazisë Gjinore, dhe keshilli bashkiak cdo muaj dhe sa here e shikojne te nevojshme

Impakti social / grupet që preken

Te gjitha kategorite dhe grupet shoqerore komunitetit te bashkise Gjirokaster. Parandalimin dhe mbrojtja nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje; Mbrojtja nga diskriminimi dhe barazia e Grave dhe Burrave në jetën vendore,.

A është objekt i konsultimit publik: . po

Komisioni i Përhershëm i "Shëndetësisë, Mirëqenies Sociale , Rinisë dhe Barazisë Gjinore" , i mbledhur me datën 28/06/2026, shqyrtoi projekt vendimit nr. _____ datë _____ 2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "**MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026–2030**" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni e me shumicë votash:

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit
- c) refuzimin e miratimit të projektaktit
- d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:
 - ✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në " _____ "
 - ✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në " _____ "
 - ✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në " _____ "
 - ✓ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në " _____ "

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Amila Loci Kryetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Arif Ahmet Sekretar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Datë 28/06/202